



Operatori i Sistemit të Transmetimit

Ftesë për Ofertë

Shqipëri

Projekti i Rimëkëmbjes së Sektorit të Energjisë Elektrike

Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.)

Prokurimi për Projektimin, Furnizimin dhe Instalimin e Zgjerimit të SCADA/EMS ekzistuese në OST sh.a. për N/St. 110 kV

Data: 18 Qershor 2019
Nr. Huasë: 8429-AL
Projekt ID: P144029
IFB Nr: PRP-S&I-ICB-10

1. Republika e Shqipërisë ka marrë një hua nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) për koston e Projektit të “Rimëkëmbjes së Sektorit të Energjisë Elektrike, Komponenti 3”. Ajo synon që pjesa e shumës së kësaj huaje do të aplikohet për pagesa të drejta për kontratën “**Projektim, Furnizim dhe Instalim të Zgjerimit të SCADA/EMS ekzistuese në OST sh.a. për N/St. 110 kV/Nr.: PRP-S&I-ICB-10**”

2. Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.) tani fton ofertuesit e ligjshëm me oferta të mbyllura në zarfe të vulosura për ndertimin dhe perfundimin e Projektimit, Furnizimit dhe Instalimit të Zgjerimit të SCADA/EMS ekzistuese në OST sh.a. për N/St. 110. Objekti i këtij investimi përfshirë projektimin, prodhimin, testimin, shpërndarjen, shërbimet e instalimit, kompletimin dhe komisionimin e pajisjeve të telekomunikacionit dhe pajisjeve RTU duke përfshirë aksesore dhe pjesët rezervë sipas Kërkesave Teknike për të gjitha nënstacionet 110 kV të listuara më poshtë:

Nr. Përshkrimi

1. Nënstacioni 110/20/10 kV BAJRAM CURRI
2. Nënstacioni 110/20 kV TUNEL
3. Nënstacioni 110/10 kV TEPELE
4. Nënstacioni 110/20 kV P.ROMANO
5. Nënstacioni 110/10 kV KELCYRË
6. Nënstacioni 110/20/6 kV GOLEM

7. Nënstacioni 110/6 kV KRUJE
8. Nënstacioni 110/20 kV TIRANA QENDER
9. Nënstacioni 110/20 kV BERAT
10. Nënstacioni 110/20 kV VLORA 2
11. Nënstacioni 110/35/20/10 kV VLORA 1
12. Nënstacioni 110/6 kV REPS

Zërat e mësipërm janë grupuar në një paketë të vetme. Vetëm një kontratë do të ketë për të gjitha zërat dhe në një përgjegjësi të vetme. Ofertat që nuk janë në përputhje me këtë kërkesë nuk do të merren parasysh për vlerësim dhe nuk do të konsiderohen për dhënien e kontratës.

Kohëzgjatja e kontratës është parashikuar tetëmbëdhjetë **(18) muaj** nga data efektive e kontratës.

3. Gara do të zhvillohet sipas procedurave të Garës Ndërkombëtare me një fazë të Bankës të specifikuar në Udhezimet e Bankës Botërore: “Blerje Mallrash, Punime, dhe Shërbimesh sipas huave të IBRD-së dhe kredive të IDA-s, & Grantëve nga Huamarrësit e Bankës Botërore, datë Janar 2011 dhe të rishikuara në Korrik 2014 (“Udhëzimet e Prokurimit”) dhe është i hapur për të gjithë ofertuesit e ligjshëm siç përcaktohet në Udhëzimet e Prokurimit. Përveç kësaj, ju lutem referojuni paragrafëve 1.6 dhe 1.7 që përcaktojnë politikën e Bankës Botërore mbi konfliktin e interesit.

4. Ofertuesit e pranueshëm të interesuar mund të marrin informacione të mëtejshme dhe të inspektojnë dokumentet e tenderit në zyrën e OST / PIU, adresa e dhënë më poshtë, nga ora 09:00 deri në orën 15:30, nga e hëna deri të premten, duke përjashtuar pushimet publike.

5. Një set i plotë i dokumenteve të tenderit në gjuhën angleze mund të blihet nga Ofertuesit e interesuar me paraqitjen e kërkesës me shkrim në adresën e mëposhtme dhe me pagesën e një tarife të pakthyeshme prej **EURO 100, 00** (njëqind euro) ose në një monedhë të konvertueshme. Menyra e pagesës do të jetë nëpërmjet depozitimit të drejtpërdrejtë në llogarinë me IBAN Code: AL11208110080000020838630702; Emri Llogarisë: “Projekti i Rimëkëmbjes se Energjisë/Komponenti 3, OST sh.a.”, mbajtur në Intesa Sanpaolo Bank, Albania,

Ose, me kërkesë të Ofertuesit të interesuar, dokumentat do të dërgohen menjëherë elektronikisht si mënyrë më e shpejtë (kjo do të bëhet pasi të ketë paguar tarifën e mësipërme), por një kopje fizike do të dërgohet gjithsesi në adresën e ofertuesit si dokumente zyrtare. Dokumentat e Tenderit Dokumentet do të dërgohen me postë ajrore për dërgim jashtë shtetit dhe me korrier për shpërndarjen lokale.

6. Ofertat duhet të dorëzohen në adresën e më poshtme në ose para orës 12:00 në mesditë. (ora lokale) më 7 Gusht 2019. **Ofertimi elektronik nuk do të jetë i lejuar.** Ofertat e vonuara do të refuzohen. Ofertat do të hapen publikisht në prani të përfaqësuesve të ofertuesve të cilët zgjedhin të marrin pjesë në adresën e mëposhtme në orën **12:00 në mesditë më 7 Gusht 2019.**

Të gjitha ofertat duhet të shoqërohen nga Sigurimi i Ofertës prej **45,000.00 EURO** (dyzet e pesë mijë euro) ose një shumë ekuivalente në një monedhë lehtësisht të konvertueshme në formën e një garanci bankare që ofrohet në dokumentet e tenderit.

7. Një vizitë, jo e detyrueshme, në vendet e zbatimit të Projektit e ndjekur nga një takim paraprak do të mbahet katër (4) javë para hapjes së ofertave në datat 10, 11, 12 Korrik 2019. Detajet do t'i njoftohen ofertuesve që do të blejnë dokumentet e tenderit. Të gjithë pjesëmarrësit në vizitë duhet të paraqesin autorizimin e tyre nga ofertuesit e mundshëm, me qëllim që të marrin pjesë.

8. Adresa e referuar më lartë është:

Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.)

Njësia e Zbatimit të Projektit (NjZP)

Albania – Projekti i Rimëkëmbjes së Energjisë Elektrike

Autostrada Tiranë – Durrës

Km 9, Yrshek, Kashar

Tiranë, Albania

Att. Mr. Taulant Saliasi, Kordinatori i Projektit

Tel./Fax: ++355 4 2225581

Web site: www.ost.al

E-mail: t.saliasi@ost.al